



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
DREJTORIA E MIRËQËNIES DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. ____ .Prot.

Peqin , më ____ .2024.

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ / ____

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

Bukurosh Maçi

“Mbi miratimin e kriterëve specifikë për përfitimin nga Skema e Ndhmës Ekonomike me 6% e Fondit të Kushtëzuar të Bllok-Ndhmës .

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës ,të ligjit nr.139/2015 "Për Qeverisjen Vendore ",të ligjit nr 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”,të ndryshuar, në pikën 13 të kreut II të V.K.M 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomikë të Këshillit të Ministrave i cili parashikon që “Këshilli bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i NE,bazuar dhe në vlerësimin social-ekonomik të bërë nga administratorët shoqëror” , gjithashtu duke u bazuar në pikën 4 të udhëzimit nr.5 datë 17.02.2017”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok-Ndhmës deri në 6% ,Sektori Social i propozon Këshillit Bashkiak Peqin.

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
3. Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:
 - a) Familje me fëmijë të mitur të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie.
 - b) Familje të cilat kanë në përbërje të tyre kryefamiljaret gra.
 - c) Familje të cilat kanë në përbërje persona me probleme shëndetësore të cilët janë të paaftë për të punuar(përfshirë Invalidët e Punës dhe personat me AK)
 - d) Familje të cilat i përkasin minoriteteve etnike dhe janë cilësuar nga administratorët shoqërorë në kushte të vështira ekonomike (familje egjiptiane,romë etj)
 - e) Familje në përbërjen e tyre shumë antare familje,por me shume të mitur .
 - f) Familje që kanë në përbërje të tyre antarë mbi moshë pune.

Drejtori i Mirqënies dhe Kujdesit Social

Ardit Çanaku

Specialiste e Ndhmës Ekonomike

Florida Haskasa